

KONTRATË SHITBLERJE
(KUOTA Kapitali)

Sot më datë 26.12.2023 (dymijë e njëzetë e tre), në përputhje me Kodin Civil, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" nenet 105 e vijues te tij, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe statutit të shoqërisë "BARDHGJANA" sh.p.k me kushtet e mëposhtme: Page |

I PALËT

Pala Shitëse : Shoqëria: "ULZA" sh.p.k me NIPT: J679029280, ne cilesine e ortakut me 46,00% te kuotes te "BARDHGJANA" sh.p.k, fakt i provuar nepermjet ekstraktit te publikuar ne web-site zyrtar te QKB per kete shoqeri ne momentin e hartimit te kontrates.



Pala Blerëse: Z. SIMON LALA, i biri i Gjok , i datelindjes 03/04/1969 , lindur ne Bulshar, Mirdite dhe banues ne Tirane, Rruga Kavaje Pall 96, mbjates i Pasaportes Biometrike me nr BB1439722 dhe nr personal G90403161H, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili eshte zoterues i 54 % te kuotave te tjera te kapitalit te shoqerise;


Kushtet Paraprake

Shoqëria "BARDHGJANA" sh.p.k, është themeluar dhe regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me Certifikatë Regjistrimit (NUIS) L12018005I, me seli në Lezhe Orosh REPS Qender Repts, Komuna Orosh, Mirdite, me kapital të regjistruar 100.000,00 (njëqindmijë) lekë, dhe përfaqësues ligjor Z.Simon Lala.

Ortakët e Shoqerise me pjesmarrjen perkatese te tyre jane si me poshte vijon:

1. Z. Simon Lala, i cili eshte zoterues i 54 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;
 2. "ULZA" sh.p.k me Nipt J679029280, e cila eshte zoterues i 46 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;
- Ortaku i shoqerise, "ULZA" sh.p.k me Nipt J679029280 zotëruese e 46% te kuotave të kapitalit të shoqërisë "BARDHGJANA" sh.p.k, ka kryer bisedime paraprake me blerësin e kuotave, me ortakun tjetër të shoqërisë, duke respektuar radhën e parablerjes së kuotave si dhe duke saktësuar midis tyre edhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë me palë të treta dhe në mardhënie me ortakët e saj, duke e njohur paraprakisht blerësin me të gjithë dokumentacionin e shoqërisë fakt për të cilin blerësi konfirmon dijeninë e tij rregullisht.
- Palët pasi kanë bërë në mënyrë individuale, vlerësimin e shoqërisë duke u bazuar në; pasqyrat financiare të publikuara deri në fund të vitit 2022; në gjendjen aktuale të aktivitetit të saj; si dhe në parashikimin e të ardhmes së natyrës së biznesit të shoqërisë për një periudhë afatmesme, lidhur me perspektivën e sektorit në të cilin ajo operon, kanë arritur në konkluzionin, se:
- a) Shoqëria në këtë datë, rezulton me kapitalin e nenshkruar, ne vlerën prej 100.000,00 (njëqindmijë) lekë dhe me fitim të mbartur akoma të pashpërndarë në shumën 52.217.409 lekë.
 - b) Ortaku aktual i shoqerisë "ULZA" sh.p.k me Nipt J679029280, ka vendosur të shesë të gjithë pjesën e tij takuese të kuotave që zotëron në masën prej 46,00% të kuotave totale prej 100,00 % të shoqërisë "BARDHGJANA" sh.p.k.
 - c) Me vendimin datë 28.12.2023 të Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur me kuorumin e 100 % te kuotave ne prani të të dy ortakëve të shoqërisë, është vendosur në mënyrë unanime, miratimi për shitjen e 46,00% të kuotave përkatëse që ortakut "ULZA" sh.p.k zotëron në shoqërinë





“BARDHGJANA” sh.p.k, në favor të blerësit **Z. Simon Lala**, duke e shderruar kete te fundit pas kesaj shitje në ortakun e vetëm të shoqërisë.

II OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate shitësi “ULZA” sh.p.k me NIPT: **J679029280**, i shet palës blerëse **Z. Simon Lala**, pjesën totale takuese të tij të kuotave të zotëruara në masën prej **46,00% të kuotave totale prej 100,00 % të kapitalit të shoqërisë “BARDHGJANA” sh.p.k**, ose 1 kuotë të saj, pra te gjithë pjesen prej 46,00% te kuotave totale te shoqerise, te cilat shitësi i zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë “BARDHGJANA” sh.p.k, dhe jane te vleresuara së bashku me fitimet deri në fund të vitit 2023 perfshi fitimet e pashpendara me vlerën e tyre nominale në shumën prej 30.000.000 lekë. Page |

III ÇMIMI

3.1 Palët shitësi “ULZA” sh.p.k , dhe blerësi **Z. Simon Lala** kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së 46,00% te kuotave te totalit te shoqerise, kuota këto që pala shitëse i shet palës blerëse **Z. Simon Lala** të jetë **30.000.000 lekë** (tridhjetëmilionë) lekë.

3.2 Palët deklarojnë se çmimi i kuotave objekt i kësaj kontrate do të likujdohet me dy këste : Kesti i pare prej 10.000.000 lekë dhe kesti i dyte prej 20.000.000 leke , nëpërmjet shpërndarjes së dividendit të akumuluar perfshi vitin 2023 pas llogaritjes edhe të tatimit mbi dividendin e shpërndarë, duke përcaktuar afatet e pagesave të këtyre kësteve, përkatësisht kësti i parë deri në fund të muajit Mars 2024 dhe kësti i dytë deri në fund të muajit Dhjetor 2024.

3.3 Palët me nënshkrimin e kësaj kontrate kanë pranuar me vullnetin e tyre të plotë mungesën e cdo lloj pretendimi për kalimin e kuotave, duke mos e bërë këtë një kontratë shitje me kusht, por i vetmi pretendim midis tyre do të jetë në lidhje me pagesën e cmimit në respektim të afateve të përcaktuara për pagesë, të cilin do ta garantojnë edhe nëpërmjet një deklarate noteriale për njohjen e kësaj shume detyrimi, për ti dhënë asaj fuqinë e titullit ekzekutiv.

IV KALIMI I PRONËSISË

4.1 Pronësia mbi 46,00 % te kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “BARDHGJANA” sh.p.k e shitesit, do të kalojë perfundimisht nga shitësi, tek pala blerëse pas dorezimit te kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje autentike nga të cilat një kopje duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), një kopje duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një kopje e marrin palet shitese dhe blerësi.

Konsiderohen pjese e kontrates dhe do ti bashkengjiten asaj per efekt te rregjistrimit aktet si me poshte:

- Vendimi i asamblese se pergjithshme te shoqerise i dates 26.12.2023 qe miraton kalimin e kuotave nga pala shitesse tek pala blerese.
- Kopjet e dokumentave te identifikimit te palës shitesse ekstrakt historik, të palës blerëse kopje të ID.

Kjo kontratë pasi u lexua me zë të lartë në prani të palëve dhe u kuptua prej tyre, dhe u gjet në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua rregullisht prej tyre.

PALA SHITËSE

“ULZA” sh.p.k
Administratori:
Nikolin SHPANI

PALA BLERËSE

SIMON LALA

VENDIM NR 4 I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE
ORTAKEVE TE SHOQERISE

Shoqeria "BARDHGJANA" sh.p.k ,

Shoqeria "BARDHGJANA" Sh.p.k, me N.I.P.T: L12018005I eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, me seli Orosh REPS Qender Repts, Komuna Orosh, Mirdite, Lezhe, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, ("Shoqeria"). Administratori i Shoqerise eshte Simon Lala.

Data e Mbledhjes: 26.12.2023

Vendi i Mbledhjes: Tirane

Ortaket e Shoqerise me pjesmarren e tyre te plote prej 100%, jane si me poshte vijon:

1. **Z. Simon Lala**, i biri i Gjok , i datelindjes 03/04/1969 , lindur ne Bulshar, Mirdite dhe banues ne Tirane, Rruga Kavaje Pall 96, mbjates i Pasaportes Biometrike me nr BB1439722 dhe nr personal G90403161H, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, eshte zoterues i 54 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;
2. "ULZA" shpk me Nipt J679029280, eshte zoterues i 46 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;

Rendi i Dites:

1. Miratimi i shitjes se 46% te kuotave te kapitalit te shoqerise "BARDHGJANA" sh.p.k qe ka ne pronesi shoqeria "ULZA" shpk, ne drejtim te ortakut tjetër te shoqerise **Z. Simon Lala**, i biri i Gjok, i datelindjes 03/04/1969 , lindur ne Bulshar, Mirdite dhe banues ne Tirane.

DUKE QENE SE:


- I. Shoqeria "BARDHGJANA" sh.p.k, eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, me seli Orosh REPS Qender Repts, Komuna Orosh, Mirdite, Lezhe, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me Numer te Unik te Identifikimit te Subjektit (NUIS) L12018005I ("Shoqeria").
- II. Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 Leke (njqind mije leke), i nenshkruar dhe shlyer plotesisht.
- III. Ortaket e Shoqerise me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, ne daten 26.12.2023, kane hyre ne bisedime per shitjen e 46% te kapitalit themeltar te shoqerise, nga ortakut "ULZA" shpk tek ortakut tjetër **Z.Simon Lala**, i biri i Gjok , i datelindjes 03/04/1969 , lindur ne Bulshar, Mirdite dhe banues ne Tirane, Rruga Kavaje Pall 96, mbjates i Pasaportes Biometrike me nr BB1439722 dhe nr personal G90403161H, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili eshte edhe zoterues i pjeses tjetër te kuotave prej 54 % te kapitalit te shoqerise, duke i finalizuar këto bisedime më datë 28.12.2023 nëpërmjet vendimit të kalimit shitjes së kuotave;
- IV. Ky vendim eshte do të merret në perputhje me nenet e Statutit te Shoqerise dhe ne respektim te plote te te gjitha dispozitave te detyrueshme te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar ("Ligji Tregtar").

PER KETO ARSYE, anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme VENDOSËN UNANIMISHT:

1. Të miratojnë transferimin e pronësisë me anë të shitjes se 46% te kapitalit themeltar nga ortakut "ULZA" shpk tek ortakut tjetër **z. Simon Lala**, në përputhje me kontratën respektive të shitjes që do të hartohet midis tyre.

ORTAKET E SHOQERISE:

z. Simon LALA



"ULZA" shpk
Administratori:

Nikolina SHPANI



VENDIM NR 6 I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE
ORTAKEVE TE SHOQERISE

Shoqeria "ULZA" sh.p.k,

Shoqeria "ULZA" Sh.p.k, me N.I.P.T: J679029280 eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, me seli TIRANE Njesia bashkiake nr 5, rruga Zef Jubani, ndertes 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, ("Shoqeria"). Administratori i Shoqerise është Nikolin Shpani.

Data e Mbledhjes: 26.12.2023

Vendi i Mbledhjes: Tirane

Ortaket e Shoqerise me pjesmarrjen e tyre te plote prej 100%, jane si me poshte vijon:

1. **Z. Ndue Shpani**, i biri i Gjetes, i datelindjes 16.06.1959, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, me nr. personal F90616110L, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, eshte zoterues i 70 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;
2. **Z. Nikolin Shpani**, i biri i Gjetes, i datelindjes 08.05.1969, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, me nr. personal G90508066W, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, eshte zoterues i 30 % te kuotave te kapitalit te shoqerise;

Rendi i Dites:

1. Miratimi i shitjes se 46% të kuotave të kapitalit të shoqerisë "BARDHGJANA" sh.p.k që ka në pronësi shoqëria "ULZA" shpk, në drejtim të ortakut tjetër të shoqerisë "BARDHGJANA" sh.p.k, **Z. Simon Lala**, i biri i Gjok, i datelindjes 03/04/1969, lindur ne Bulshar, Mirdite dhe banues ne Tirane.

DUKE QENE SE:


- I. Shoqeria "ULZA" sh.p.k, eshte ortak e shoqerisë "BARDHGJANA" sh.p.k duke pasur në pronësi të saj 46% të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie,
- II. Ortaket e Shoqerise me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, kane hyrë në bisedime për shitjen e 46% te kapitalit themeltar te shoqerise, nga ortaku "ULZA" shpk tek ortaku tjetër **Z.Simon Lala**, i cili eshte edhe zoterues i pjeses tjetere te kuotave prej 54 % te kapitalit te shoqerise, duke i finalizuar këto bisedime më datë 26.12.2023 nëpërmjet vendimit të kalimit shitjes së kuotave;
- III. Ky vendim eshte do të merret në përputhje me nenet e Statutit te Shoqerise dhe ne respektim te plote te te gjitha dispozitave te detyrueshme te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar ("Ligji Tregtar").

PER KETO ARSYE, anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme VENDOSËN UNANIMISHT:

1. Të miratojnë transferimin e pronësisë me anë të shitjes totale të kuotave prej 46% të kapitalit themeltar në pronësi të ortakut "ULZA" shpk tek ortaku tjetër **z. Simon Lala**, për cmimin total të shitjes prej 30.000.000 lekë, në përputhje me kontratën respektive të shitjes që do të hartohet midis shitësit dhe blerësit.

ORTAKET E SHOQERISE:

Ndue SHPANI



Nikolin SHPANI

